



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 qershor 2023  
Nr. ref.:RK 2203/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI150/22**

Parashtrues

**Blerim Gashi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktgjykimit [Pml. nr. 284/2022] të 28 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme të  
Republikës së Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Blerim Gashi, me vendbanim në Fushë-Kosovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ramë Gashi, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 284/2022] të 28 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [APS. nr. 14/2022] e 26 majit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PS. nr. 18/2021] e 11 shkurtit 2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij, të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e te Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenet 5 [E drejta për liri dhe siguri] dhe 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 10 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 tetor 2022, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI150/22 caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare raportuese për rastin dhe me Vendimin KSH. KI150/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 11 tetor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 23 maj 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 4 mars 2020, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Prokuroria speciale), ngriti Aktakuzën [PPS. nr. 24/2020], kundër parashtruesit të kërkesës, në cilësinë e zyrtarit policor, dhe kundër R. I., në cilësinë e gjyqtarit, nëpërmjet

së cilës të njëjtit akuzoheshin për kryerje të veprës penale “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 424, paragrafi 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK). Sipas aktakuzës, të dy të akuzuarit akuzoheshin se më 28 gusht 2019 nga F. Z. kishin pranuar përfitim pasuror në mënyrë që të ushtrojnë ndikim tek Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë për të marrë vendim për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim të shqiptuar nëpërmjet Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ndaj F. Z, dhe njëkohësisht të ndikojnë tek gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës për prishjen e këtij aktgjykimi nëpërmjet mjetit të jashtëzakonshëm juridik, kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

11. Gjykata vë në dukje se vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta përfshijnë procedurën penale ndaj parashtruesit të kërkesës dhe R. I, njëkohësisht. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vë në pah se R. I, ka parashtruar kërkesë të veçantë në Gjykatë me numër KI174/22, e cila u shpall e papranueshme nga Gjykata me Aktvendimin e 5 prillit 2023. Prandaj, gjatë pasqyrimin të kronologjisë procedurale të rastit, Gjykata, për aq sa është e mundur, do të përqendrohet në përmbajtjen e vendimeve të gjykatave të rregullta të nxjerra në procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës dhe të parashtrësve të paraqitura që ndërliidhen vetëm me të.

*a. Procedura hetimore/ngritja e aktakuzës*

12. Më 7 maj 2019, Prokuroria Speciale nisi hetimet ndaj parashtruesit të kërkesës, në cilësinë e zyrtarit policor, për shkak të dyshimit të bazuar se kishte kryer veprën penale “*Marrje e rryshfetit*” nga neni 428, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
13. Më 15 gusht 2019, Prokuroria speciale zgjeroi hetimet në këtë rast penal, duke përfshirë dhe R. I., si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “*keqpërdorim i pozitës zyrtare ose autoritetit zyrtar*” nga neni 422, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.
14. Më 4 mars 2020, Prokuroria speciale ngriti Aktakuzën PPS. nr. 24/2020, kundër parashtruesit të kërkesës dhe R. I., mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale “ushtrim i ndikimit” nga paragrafi 1, neni 424 i KPRK-së.

*b. Procedura e gjykimin të rastit penal*

15. Më 18 dhjetor 2020, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin PS. nr. 14/2020, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të lartcekur, duke e dënuar të njëjtin me burgim efektiv në kohëzgjatje prej dy (2) vjet, e gjashtë (6) muaj, duke ia llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, nga 26 shtatori 2019, deri më 18 nëntor 2019. Parashtruesi i kërkesës po ashtu është dënuar me gjobë në shumën prej 2000 (dymijë) euro. Gjykata Themelore, përveç dënimit me burgim efektiv dhe me gjobë, parashtruesit të kërkesës, si masë plotësuese, ia shqiptoi ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, pas vuajtjes së dënimit.
16. Parashtruesi i kërkesës, në afat ligjor, ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [PS. nr. 14/2020] të 18 dhjetorit 2020 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe shkelje të ligjit penal. Kundër të njëjtit Aktgjykim, ankesë kishte parashtruar dhe Prokuroria Speciale, nëpërmjet së cilës kërkoi ashpërsim të dënimit.

17. Më 22 prill 2021, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin [APS. nr. 10/2021], aprovon ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e kthen rastin penal në rigjykim pranë Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e vendimit, Gjykata e Apelit, kërkoi nga gjykata e shkallës së parë, që në procedurën e rivendosjes t'i administronte përsëri të gjitha provat, të marr në pyetje edhe dëshmitarë tjerë, konkretisht dëshmitarin N. K. dhe R. K., të japë arsye të qarta për veprimet inkriminuese të të akuzuarve, përfshirë natyrën juridike të shkeljeve, të vërtetojë faktet vendimtare në ndërlidhje me aspektin subjektiv të përgjegjësisë penale të të akuzuarve, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerrë konkluzione të drejta dhe të ligjshme.

*c. Procedura e rigjyimit*

18. Më 11 shkurt 2022, Gjykata Themelore, duke vendosur sipas gjetjeve të Gjykatës së Apelit, nxori Aktgjykimin PS. nr. 18/2021, me të cilin shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës, dhe pasi vlerësoi rrethanat lehtësuese të rastit, vendosi që t'ia ulë masën e dënimit me burgim efektiv, nga dy (2) vjet e gjashtë (6) muaj, në njëzetë (20) muaj dhe dënimin me gjobë nga 2000 (dymijë), në 1000 (njëmijë) euro, duke lenë në fuqi ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh, pas vuajtjes së dënimit me burgim efektiv. Në arsyetim të Aktgjyimit, ndër të tjera, theksohet: *"Pasi që gjykata bëri administrimin e provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, të njëjtat i vlerësoi dhe analizoi me kujdes e me ndërgjegje, secilën veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 të KPPR-së, vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në diapozitivin e këtij aktgjykimi, se të akuzuarit R. I., dhe Blerim Gashi, kanë kryer veprën penale secili veç e veç, Ushtrimi i ndikimit nga neni 424, paragrafi 1 të KPPR-së"*.
19. Më 31 mars 2022, parashtruesi i kërkesës ushtroj të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit, ndaj Aktgjyimit të 11 shkurtit 2022 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, nga neni 386 i KPPR-së, shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 dhe 1.12, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i KPPR-së, shkelje të ligjit penal, për shkak të vendimit për dënimin me burg efektiv dhe gjobë, si dhe për shkak të ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh, pas vuajtjes efektive të dënimit me burgim.
20. Më 26 maj 2022, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [APS. nr. 14/2022], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ankesën e Prokurorisë Speciale dhe vërtetoi Aktgjykimin e ankimuar, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në arsyetimin e Aktgjyimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi se aktgjykimi i ankimuar nuk ishte përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale apo shkelje të ligjit penal dhe se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë kishte vërtetuar gjendjen faktike.

*d. Mjeti i jashtëzakonshëm*

21. Më 7 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrorë kërkesës për mbrojtje të ligjshmerisë kundër Aktgjyimit të 26 majit 2022 të Gjykatës së Apelit, me pretendimin për shkelje të ligjit penal nga neni 424, paragrafi 1 i KPPR-së, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, dhe nënparagrafi 1.12 i KPPR-së, dhe shkeljes së dispozitave të procedurës penale me ndikim në ligjshmerinë e vendimit gjyqësor, nga neni 384, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i KPPR-së.

22. Më 19 korrik 2022, Zyra e Kryeprokurori të Shtetit, me parashtruesën KLMP. II. nr. 175/2022, propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruar nga mbrojtësit e të dënuarave të refuzohet si e pabazuar.
23. Më 28 korrik 2022, Gjykata Supreme me Aktgjykimin [Pml. nr. 284/2022], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe la në fuqi aktgjykimet e instancave më të ulëta. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme, u deklarua se: *“... mbështet në tërësi arsyetimin e dhënë nga dy instancat më të ulëta dhe me fokus të veçantë në arsyetimin e mbrojtjes së të dënuarve, duke e ndërlidhur mbrojtjen e tyre me provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenet 5 [E drejta për liri dhe siguri] dhe 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

#### *i. Pretendimet përkitazi me “mënyrën e administrimit të provave”*

25. Sa përket aspektit të administrimit të provave parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Themelore nuk është mbështetur në prova të drejtpërdrejta të cilat shërbenin për nxjerrjen e konkluzioneve të sakta për çdo dyshim mbi fajësinë e tij, duke respektuar kështu parimin e prezumimit të pafajësisë, sanksionuar nga Kushtetuta dhe nga Kodi Penal. Në këtë kontekst parashtruesi i kërkesës pyet nëse është respektuar instituti i provave penale, sa i përket zbulimit dhe të provuarit të së vërtetës në këtë çështje. Parashtruesi i kërkesës në këtë drejtim thekson: *“që një provë të jetë e vlefshme për t'u marrë dhe vlerësuar në procedurën penale, ajo duhet të pasqyrojë të dhëna rreth fakteve dhe rrethanave të kryerjes së një veprë penale të caktuar dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij dhe se këto prova duhet detyrimisht që të merren e administrohen sipas rregullave të parashikuara në dispozitat të veçanta”*.
26. Parashtruesi i kërkesës në vazhdim pretendon se *“Gjykata e Apelit, gjatë vendosjes lidhur me ankesën e të pandehurit, nuk e pa të udhës që të hynte në më shumë detaje lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike, ajo nuk ka marrë si fakt shumë të rëndësishëm provat shfajësuese të të pandehurit gjatë zhvillimit të procedurës penale”*.
27. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“do të duhej të vihet në dukje se çdo paqartësi ose dyshim që lind nga provat duhet të zgjidhet nga Trupi gjykues - kolegji në favor të të pandehurit Blerim Gashi, në përputhje me parimin e in dubio pro reo. Gjykata e Apelit ka pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ka marrë parasysh dëshmitë e personit labil (të cilin labilitet tani do ta vlerësoj dhe dëshmoj gjykata kompetente sipas kërkesës të mbrojtësit të pandehurit për përsëritjen e procedurës), meqë vet ky dëshmitarë e ka thirrë në telefon të pandehurin dhe i ka kërkuar falje duke i thënë që ka qenë i detyruar të deklarojë një gjë të tillë. Gjykata e Apelit ndoshta do të duhej të vlerësonte se prova më bindëse do të ishin provat tjera për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurën penale”*.

28. Parashtruesi i kërkesë pretendon se edhe Gjykata Supreme vendosi njëjtë sikurse Gjykata e Apelit, duke mos përfillur shkeljet e pretenduara të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se Gjykata Supreme ka qenë e obliguar të mënjanojë shkeljet ligjore nga vendimi i plotfuqishëm mbi dënimin e tij dhe kësaj të anulojë vendimin për dënimin dhe të urdhëroi mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të ri, sipas nenit 439 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Mbi këtë bazë parashtruesi i kërkesës mëton se Gjykata Supreme, duke vepruar si gjykatë e shkallës së tretë nuk ka dhënë arsye të qarta juridiko-kushtetuese përkitazi me të gjitha faktet të cilat ishin relevante për dhënien e një vendimi të ligjshëm, por në mënyrë eksplicite, i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet ankimore të kërkesës së tij.
29. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se *“F.Z. ka qenë dëshmitari i cili ka ndihmuar prokurorinë për ngritjen e aktakuzës, kurse prej fillimit të procedurës mbrojtja kishte bërë vërejtje se ky dëshmitarë para gjykatës e ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme qëndrimin e tij në krahasim me fazën e procedurës paraprake. Mirëpo, prapë se prapë, deklaratat e tij gjatë procedurës paraprake janë pranuar si prova direkte. Dëshmia e tij në gjykatë nuk ka qenë e besueshme dhe bindëse”*.

*ii. Pretendimet përkitazi me parimin e “barazisë së armëve”*

30. Parashtruesi i kërkesë në lidhje me këtë pretendim, thekson se Gjykata Themelore nuk ka respektuar nenin 6 të KEDNj-së, nga fillimi i procedurës së caktimit të paraburgimit, e deri në marrjen e aktgjykimit, si dhe vendimin për dënimin, sepse kjo e fundit nuk ka mundësuar qasje të barabartë të palëve në procedurë, gjegjësisht nuk është respektuar parimi i proporcionalitetit në mes të prokurorit dhe të pandehurit, në asnjë moment nuk janë bazuar në veprimet e policisë kundër të pandehurit, të deklarimeve të dëshmitarit jokredibil F. Z., joserioz, i lëkundur dhe jo i besueshëm, me çka nuk ishte vlerësuar drejtë fakti se i pandehuri nuk kishte planifikuar, nuk kishte përmendur as njerëz dhe as ndonjë veprim për t'i kryer favore dëshmitarit apo të ushtronte ndikim të ndonjë gjyqtarë lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, që kishte të bënte me vet dëshmitarin.
31. Parashtruesi i kërkesës përkitazi me këtë pretendim i referohet praktikës së GjEDNj-së, rastit *Dombo Beheer kundër Holandës*, ku është theksuar se çdo palë duhet të ketë kushte jo më pak të favorshme se pala kundërshtarë për paraqitjen e çështjes para gjykatës. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se duhet e shikohet në këtë rast nëse është respektuar barazia e palëve, dhe se a ishte “adekuate” dhe e “përshtatshme” mundësia e administrimit të provave kryesore.
32. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës vë në pah se pretendimi i tij kryesor ndërlidhet me marrjen parasysh të “provave për përcaktimin e fajësisë” dhe ekzistimin e vet subjektit të veprës penale, duke shtuar se mënyra se si u morën provat në rastin e tij ishte e padrejtë.

*iii. Pretendimet tjera*

33. Në lidhje me pretendimet tjera për shkeljet të lartpërmendura të nenit 24, 29, 30, 53 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe nenin 5 të KEDNj-së, parashtruesi i kërkesës nuk shtjellon tutje se si dhe pse janë shkelur ato nene konkrete.

34. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese të pranojë këtë rast dhe të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të tij, të garantuara me nenet 24, 29, 30, 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 5 dhe 6 të KEDNj-së.

### **Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore**

## **KUSHTETUTA E REPUBLIKES SË KOSOVËS**

### **Neni 24**

#### **[Barazia para Ligjit]**

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.  
[...]

### **Neni 29**

#### **[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]**

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:
- (1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
  - (2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
  - (3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
  - (4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
  - (5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.
2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyt e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyt e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.
3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.
4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.
5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.
6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

**Neni 30**  
**[Të Drejtat e të Akuzuarit]**

*Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:*

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;*
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;*
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;*
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;*
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.*

**Neni 31**  
**[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*  
*[...]*

**Neni 53**  
**[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]**

*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

**Neni 54**  
**[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*

**Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

**Neni 5**  
**(E drejta për liri dhe siguri)**

- 1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:*
  - a. kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;*
  - b. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;*
  - c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;*
  - d. kur një i mitur ndalohet ligjërisht për qëllim edukimi të mbikëqyrur ose për ndalimin e tij të ligjshëm me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;*



- e. kur ndalohet ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;
- f. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose nëse kundër tij është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;
2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.
3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.
4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
5. Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.

## Neni 6

### (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

## KODI NR. 04/L-082 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### Neni 424

#### (Ushtrimi i Ndikimit)

1. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, me pretendimin se ai apo ajo është në gjendje të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, zyrtarit të huaj publik ose personit të huaj zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
2. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit tjetër, në mënyrë që ky person të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, zyrtarit të huaj publik ose personit të huaj zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tetë (8) vjet.

[...]

## Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

### Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

[...]

37. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

### Neni 47 (Kërkesa individuale)

*1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

### Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

### Neni 49 (Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.*

38. Rreth përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 284/2022] të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

39. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nënregullin 2 të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 39  
(Kriteret e papranueshmërisë)

*2 Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuzë dhe të paqarta*” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, kategoria (iii)).
41. Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, një ankesë karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (shih, rastin e GjEDNj-së: [Talpis kundër Italisë](#), nr. 41237/14, Aktgjykimi i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).
42. Gjykata, duke iu rikthyer shqyrtimit të kërkesës rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i 28 korrikut 2022 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të neneve 24, 29, 30, 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe neneve 5 dhe 6 të KEDNj-së).
43. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës vëren se esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, siç e cekë edhe vetë parashtruesi i kërkesës ka të bëjë me parregullsinë e procesit gjyqësor, gjegjësisht me shkeljen e të drejtës së tij për gjykim të drejtë, e cila ndërlihet me:



- (i) mënyrën e administrimit të provave, dhe
- (ii) parimin e barazisë së palëve (armëve)

44. Andaj, pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës Gjykata do i shqyrtojë dhe analizojë nga pikëpamja e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në dritën e interpretimit të nenit 6 të KEDNj-së, duke aplikuar parimet e përcaktuara nëpërmjet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në bazë të të cilave Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që: “*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.

### **i. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me “mënyrën e administrimit të provave”**

#### *a) Parimet e përgjithshme*

45. Në vijim dhe në kontekst të pretendimit specifik përkitazi me mënyrën e administrimit të provave nga gjykatat e rregullta, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, e cila në parim ka theksuar se, “*Ndonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave si të tillë, një fushë kjo që u përket për këtë arsye në radhë të parë të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare*” (shih, rastin GJEDNj-së [Schenk kundër Zvicrës](#), nr. 10862/84, Aktgjykimi i 12 korrikut 1988, paragrafët 45-46).
46. Megjithatë, GjEDNj ka nënvizuar se aspekti që duhet shqyrtuar në këto raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih, rastet e GJEDNj-së [Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 35394/97, Aktgjykimi i 12 majit 2000, paragrafi 34; [P.G. e J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 44787/98, Aktgjykimi i 25 shtatorit 2001, paragrafi 76; dhe [Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 48539/99, Aktgjykimi i 5 nëntorit 2002, paragrafi 42).
47. Rrjedhimisht, nëse procedura ishte e drejtë në tërësi, duhet pasur parasysh nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi/ja i/e kërkesës kishte mundësi ta kontestoj ligjshmërinë e provave dhe të kundërshtoj përdorimin e tyre (shih, rastin e GJEDNj-së, [Szilagyi kundër Rumanisë](#), kërkesa nr. 30164/04, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2013; shih po ashtu rastin e Gjykatës KI34/18, parashtrues [Albert Berisha](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 23 majit 2018, paragrafi 63).
48. Më saktësisht, GJEDNj ka nënvizuar se kur prova është shumë e qëndrueshme dhe nuk vihet fare në dyshim, nevoja për prova të tjera në mbështetje të saj bëhet më e vogël (shih rastet e GJEDNj-së, [Bykov kundër Rusisë](#), [DhM], nr. 4378/02, Aktgjykimi i 10 marsit 2009, paragrafi 89, dhe referencat tjera të përmendura aty; [Jalloh kundër Gjermanisë](#), nr. 54810/00 [DhM], Aktgjykimi i 11 korrikut 2006, paragrafi 96). Rrjedhimisht, GJEDNj ka theksuar se i kushton gjithashtu rëndësi çështjes nëse prova në fjalë ka qenë apo jo përcaktuese për rezultatin e procesit penal (shih, rastin [Gäfgen kundër Gjermanisë](#), [DhM], nr. 22978/05, Aktgjykimi i 1 qershorit 2010, paragrafi 164).

#### *b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*

49. Referuar, pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, përkitazi me mënyrën administrimit të provave nga gjykatat e rregullta, Gjykata rikujton se thelbi i ankesës së parashtruesit të

kërkesës ka të bëjë me pranueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit F. Z, duke thekuar se Gjykata Themelore, ia fali besimin këtij dëshmitari edhe përkundër faktit se i njëjti kishte ndryshuar deklarinimin e tij nga procedura paraprake e deri te shqyrtimi kryesor gjyqësor.

50. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve procedurale lidhur me marrjen, administrimin, verifikimin dhe çmuarja e provave dhe në tërësi procesin e të provuarit, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së.
51. Gjykata, në lidhje me këtë pretendim i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [PS. nr. 14/2022] të 11 shkurtit 2022 të Gjykatës Themelore, e cila përkitazi me (i) analizën e provave, ndër të tjera, arsyetoi: “ c) U vërtetua se dëshmitari, F.Z., ishte shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktgjykimin P.nr.120/15, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) vite e dhjetë (10) muaj, i cili aktgjykim ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktgjykimin PAKR.nr.329/19 e datës 29.07.2019, duke marrë formën e prerë. ... e) U vërtetua se të akuzuarit me datë 28.08.2019, pranuan të holla nga dëshmitari F.Z., në veturën e tij (dëshmitarit), derisa udhëtonin së bashku dhe atë i akuzuari R.I, shumën e të hollave prej 1500 €, ndërsa i akuzuari Blerim Gashi shumën e të hollave prej 1000 €, që të dy ndaras nga njeri tjetri. (...)”
52. Përkitazi me (ii) dëshmitë e dëshmitarëve, Gjykata Themelore, arsyetoi: “(...) Dëshmitari gjatë kësaj periudhe të shoqërimit nga policët, kishte biseduar me të dy të akuzuarit R.I, dhe Blerimin si dhe me policin V.SH, dhe Blerimi më pas e kishte telefonuar edhe R.I, të cilit i kërkonte që t'i ndihmojnë se kishin obligim moral ndaj tij dhe ky komunikim dhe kërkesë që t'i ndihmojnë ishte pasi që dy të akuzuarit nga dëshmitari F.Z, i kishin pranuar të hollat, R.I, 1500 € e Blerimi 1000 €. (...) Sa i përket të akuzuarit Blerim Gashi, dëshmitari F.Z, vërtetoi faktin se të njëjtin e kishte njohur para dy viteve kur e kishte angazhuar për nxjerrjen e pensionit të nënës së tij dhe përmes Blerimit e kishte njohur një police, që punon në gjykatë ku edhe takimet me gjyqtarë i kishte zhvilluar përmes Blerimit dhe asaj. (...) Fjalët e dëshmitarit u vërtetuan edhe me prova materiale, se i akuzuari Blerim Gashi, gjatë bisedës telefonike me dëshmitarin i kishte thënë se nuk i lejohet me ligj me i bo këto punë se është me uniformë, është person zyrtar dhe nuk i lejohet biseda me të, por e kishte trajtuar si mik në familje dhe kishin biseduar privatisht dhe i kishte kërkuar dëshmitarit, që nëse e pyet dikush për të t'iu thotë se me të ishin takuar vetëm për pensionin e nënës së tij. (...). Fakti se ishin të hollat e policisë që dëshmitari ua kishte dhënë të akuzuarve, këtë e ka vërtetuar edhe dëshmitari V. Sh., i cili ishte hetuesi i rastit, e që ka vërtetuar se pikërisht pse po i kërkonin të holla e kishte paraqitur rastin në antikorrupsion dhe më pas edhe kishte bashkëpunuar me policinë dhe prokurorinë dhe telefoni i tij ishte vënë në përgjim, e për atë arsye edhe në ditën e takimit me të akuzuarit ua kishte dhënë mjetet, të hollat e policisë, e jo të vetat, edhe pse të akuzuarit thirren në atë se i kishin marrë hua, për t'ia kthyer. Por që kjo nuk doli të jetë e vërtetë. (...) Dëshmia e dëshmitarit F.Z., për gjykatën ishte bindëse dhe në përputhje të plotë me provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, andaj të njëjtës gjykata ia fali besimin në tërësi dhe për gjykatën dëshmia e tij ishte bindëse, kurse dëshmisë së dëshmitarëve A.H., dhe S.T., vetëm pjesërisht ua fali besimin, ... Po ashtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve N. K, R. K, dhe V. Sh, dëshmia e tyre ishte objektive dhe bindëse dhe gjykata ua fali besimin në tërësi”.
53. Përkitazi me (iii) vlerësimin e provave materiale, Gjykata Themelore, arsyetoi si në vijim: (...) “Tërë këto biseda të përgjuara janë në pajtueshmëri të plotë me dëshminë e dëshmitarit, se të njëjtën ditë që ishte arrestuar diku rreth orës 18:00 ishte liruar, të cilit

edhe gjatë asaj kohe i ishte mundësuar komunikimi me R.I., i cili edhe i kishte ndihmuar, e po ashtu kishte ndihmuar edhe Blerimi, që ta mbanin më gjatë në polici, derisa ta transferojnë në qendrën e paraburgimit, por pasi që ishte liruar, që të dytë, R. I. dhe Blerimi e kishin telefonuar dhe i kanë thënë se e kishin ndihmuar dhe që të dytë i kishte falënderuar”. (...) Gjendja e tillë faktike u vërtetua bindshëm edhe nga foto dokumentacioni, ku u vërtetua se të akuzuarit dhe dëshmitari ishin takuar dhe se kishin biseduar lidhur me çështjen e dëshmitarit, në veturën e tij i kishin pranuar të hollat prej tij, ku kishin lëvizur me veturë, në vendet ku kishin ndaluar, kishin ngrënë së bashku dhe se nga këto u vërtetua se të njëjtit kishin raporte të afërta. (...) “... nga provat materiale, dëshmia e dëshmitarit Z., ekskluzivisht nga bisedat e përgjuara telefonike e të cilat janë shtjelluar më lart është vërtetuar gjendja faktike sikurse në diapozitivin e këtij aktgjykimi. (...) Meqë provat e lartshënuara materiale kishin bazë ligjore, ishin nxjerrë në procedurë hetimore bazuar në urdhra e vendime të ligjshme, të njëjtat gjykata i konsideroi si prova të besueshme, të pranueshme që janë në përputhshmëri njëra me tjetrën, andaj edhe ua fali besimin e plotë”.

54. Përkitazi me (iv) pretendimet e mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore, arsyetoi: “Pretendimet e mbrojtësit Blerim Gashi, avokatit Ramë Gashi, se akuza e prokurorisë ka dështuar që të vërtetohet se në veprimet e të mbrojturit të tij manifestohen elementet e veprës penale, ngase nuk ka vërtetuar se cili ishte ushtrimi i ndikimit të të mbrojturit të tij në Gjykatën Supreme, te cili gjykatës, ngase akuza është mbështetur vetëm në dëshminë e dëshmitarit F.Z., dhe përgjimeve, ngase dy dëshmitarët A.H. dhe S. T., as që e njihnin Blerimin, dëshmitari theksoi se Blerimit ia kishte dhënë 1000 € se i kishte ndihmuar diçka rreth policisë që me e mbajt më gjatë, kurse dëshmitari ishte angazhuar për nxjerrjen e pensionit të nënës së Blerimit i cili disa herë i kishte dhënë të holla të cilat do t’ia kompensonte kur i del pensioni, por gjykata ka vërtetuar se provat e propozuara nga organi i akuzës e të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, kanë vërtetuar se i akuzuari me veprimet e tij ka kryer veprën penale të përshkruar sikurse në dispozitivin e aktgjykimit, ngase edhe në përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit nuk është cekur se tek cili gjyqtar i Gjykatës Supreme ka ushtruar ndikim, si dhe pretendimi se disa herë i kishte dhënë të holla derisa t’i del pensioni, kjo nuk është kontestuese, ngase atë as nuk janë pjesë e kësaj akuze, por vetëm shuma e të hollave prej 1000 € të hollat e policisë e të cilat dëshmitari ia dha në veturën tij. Rrjedhimisht, të gjitha pretendimet e mbrojtësve gjykata i vlerësoi të njëanshme dhe me qëllim të mbrojtjes së interesave dhe zvogëlimit të përgjegjësive të të mbrojturve të tyre, andaj pretendimeve të tilla nuk ua fali besimin”.
55. Përkitazi me (v) vlerësimin ligjor të veprës penale, Gjykata Themelore, arsyetoi: “Kjo vepër penale është e radhitur në kapitullin e veprave penale kundër detyrës zyrtare, duke e keqpërdorur dhe shfrytëzuar pozitën zyrtare në Institucionet e Republikës së Kosovës. Që të dy të akuzuarit ishin persona zyrtarë, i akuzuari R. I., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – dega në Skenderaj, ndërsa i akuzuari Blerim Gashi, polic në Policinë Kosovës. Me këtë vepër penale inkriminohen intervenimet e personit zyrtar kompetent për interes të personit të tretë, në këtë rast personi i tretë ishte dëshmitari F.Z., i dënuar me dënim burgimi. Këtë vepër penale e kryen kushdo që kërkon, merr ose pranon, një ofertë ose një përparësi për vete apo për tjetrin. Vepra penale konsumohet nga vet pranimi i dhuratave apo përfitimeve ose nga pranimi i ofertave a premtimeve për dhuratë ose përfitime tjera. Nuk kërkohet që të ndodh patjetër ndërmjetësimi - ndikimi dhe aq më pak që ndikimi të ketë sukses e cila vepër penale kryhet vetëm me dashje. Andaj, gjykata vlerëson se të akuzuarit R.I., dhe Blerim Gashi, që të dytë kanë kryer veprën penale me dashje dhe atë duke pranuar të mira materiale nga dëshmitari - të hollat, me

qëllim të ushtrimit të drejtpërdrejt të ndikimit në çështjen e tij dhe se vetëm premtimi i tyre se do të ndikojnë, me këto veprime janë konsumuar elementet e veprës penale, pavarësisht nëse ndikimi i tyre ishte ushtruar apo jo dhe aq më pak nëse ndikimi i tyre të ketë pasur sukses.(...) Gjykata i ka dëgjuar edhe dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja e që ishte edhe rekomandimi i Gjykatës së Apelit, N. K., dhe R. K., emrat e shumëpërfolur nga i akuzuari R.I., në bisedat e përgjuara se përmes tyre ishte ushtruar ndikim lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim, ngase pavarësisht faktit nëse tek dëshmitari N.K., qoftë direkt ose nëpërmjet dëshmitarit R.K., ishte ushtruar ndikim, e që dëshmitarët e dëgjuar fare nuk ishin në dijeni për çështjen e F.Z., në veprimet e të akuzuarit R.I., janë përmbushur elementet e figurës së veprës penale, nga vet premtimi i bërë ndaj dëshmitarit. Gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarve janë përmbushur të gjitha elementet e duhura që kanë formësuar tiparet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale Ushtrimi i ndikimit, nga neni 424, paragrafi 1 të KPRK-së, (...)."

56. Përkitazi me (vi) vendimin mbi dënimin, Gjykata Themelore, arsyetoi se, "... si rrethana relativisht lehtësuese ndaj të dy të akuzuarve mori gjendjen e tyre mesatare materiale ku që të dy, të hyrat familjare i kishin siguruar nga paga që kishin pranuar në institucionet ku punonin, se duhet të kujdesen edhe për familjet e tyre. Në bazë të dhënave që i posedon kjo gjykatë mbi të dënuarit (të dhënat nga zyra e regjistrimit) është hera e parë që bien ndesh me ligjin dhe më herët nuk janë dënuar me aktgjykim të formës së prerë për ndonjë vepër penale, (...)" "...i akuzuari Blerim, person zyrtar, polic në Policinë e Kosovës, me detyrat dhe udhëzimet për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale dhe kryesve të tyre, hetimin e veprave penale dhe kryesve të tyre, ashtu që pozitat që i mbanin të akuzuarit jo vetëm që dëshmojnë shkallën e lartë të dashjes dhe pjesëmarrjes së tyre në kryerjen e veprës penale, por roli i tyre si autoritete pranë institucioneve të tyre ka qenë që të bëjnë parandalimin e këtyre dukurive negative, respektivisht parandalimin e keqpërdorimeve të çfarëdo lloji të jenë, ndërsa në anën tjetër këta të akuzuar vet kanë tejkaluar kompetencat e tyre për përfitim material. Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të larttheksuara, të akuzuarve iu shqiptoi dënimet sikurse u theksua në diapozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se edhe me këto dënime të shqiptuara ndaj tyre do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahen nga këto veprime / kryerja e veprave penale".
57. Gjykata tutje rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe Gjykata e Apelit, gjatë vendosjes lidhur me ankesën e tij, nuk e pa të udhës që të hynte në më shumë detaje lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike, dhe se ajo nuk i mori si të rëndësishme provat shfajësuese gjatë zhvillimit të procedurës penale.
58. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [APS. nr. 14/2022] të 26 majit 2022 të Gjykatës së Apelit, e cila, arsyetoi: "Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilave u referohen mbrojtësit në ankesa, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin, gjithashtu edhe përpilimi i dispozitivit është bërë konform dispozitave të nenit 370, par. 4 e lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, ku janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprës penale, nga neni 424, par. 1 të KPRK-së, për të cilën të akuzuarit R.I. dhe Blerim Gashi, janë shpallur fajtorë. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke vepruar kështu, pra, konform dispozitave të nenit 370, par. 6 të KPPK-së, ku, gjykata e shkallës së parë, **ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike**".



59. Në vazhdim, Gjykata vëren se pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të fakteve, Gjykata e Apelit, u është përgjigjur, si në vijim: “... pretendimet ankimore të mbrojtëseve të të akuzuarve, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje, sikurse që pa të drejtë pretendohet në ankesat e ushtruara”.
60. Tutje, Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj, theksoi se: “... gjendjen e tillë faktike gjykata shkallës së parë e ka vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, siç janë dëgjimi i dëshmitarëve: F.Z., A.H, S.T, N.K, dhe V.Sh, si dhe provat materiale; kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, transkriptet e përgjimit për të akuzuarin R.I, transkriptet e komunikimit të siguruar përmes masave të fshehta të monitorimit në vende publike dhe private për të akuzuarit R.I dhe Blerim Gashi, fotodokumentacioni i shkresave të lëndës si dhe CD që kanë të bëjnë me aplikimin e masave të fshehta të përgjimit, ...duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë me lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar”.
61. Ndërsa, përkritazi me pretendimet për shkeljen e ligjit penal Gjykata e Apelit arsyetoi: “Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal siç pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve në ankesat e tyre. Kjo për faktin se veprimet e të akuzuarve i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën të njëjtit janë shpallur fajtorë, se për këtë vepër penale të njëjtit janë penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të akuzuarve”.
62. Për më tepër, Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkritazi me mënyrën e administrimit e provave është adresuar edhe nga Gjykata Supreme, e cila në Aktgjykimin e saj, arsyetoi: “Sa i përket pretendimeve se në veprimet e të dënuarve nuk janë formësuar elementet e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtorë të dënuarit, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimet e tilla të potencuara në të dy kërkesat nuk janë të bazuara pasi që në aktgjykimet e kundërshtuara janë paraqitur arsye të mjaftueshme përkritazi me veprimet e të dënuarve. (...). Në mënyrë të ngjashme edhe sa i përket të dënuarit tjetër Blerim Gashi është evidente se kanë krijuar përshtypjen tek i dënuari se do të mund të ndikojnë në vendimmarrjen e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe po ashtu edhe tek kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përkritazi me ndaljen e ekzekutimit të dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë”.
63. Tutje, Gjykata Supreme, sa i përket pretendimeve për shkeljen e ligjit, ka konstatuar: “Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se dispozita e nenit 424, par. 1 të KPRK-së, në mënyrë lehtë të interpretueshme ka përcaktuar se vepra penale realizohet edhe nëse nuk arrihet rezultati i synuar, megjithatë vepra penale realizohet. Mbi bazën e kësaj, ... vlerësojmë se interpretimi i bërë nga ana e dy instancave të ulëta gjyqësore është në harmoni të plotë edhe me interpretimin e kësaj gjykate, andaj në këtë rrafsh nuk ka asnjë dallim në interpretim të kësaj dispozite edhe nga ana e kësaj gjykate elementet e veprës penale ushtrimi i ndikimit të përcaktuara me dispozitën e lartcekur nuk kërkojnë arritjen e rezultatit në vendimmarrje, por mjafton realizimi i veprës penale, vetëm krijimi i përshtypjes tek i dëmtuari se ndikimi do të realizohet, pra pavarësisht nëse ndikimi është



*ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar. Pra, nuk kërkohet ushtrimi i ndikimit dhe aq më pak rezultati i synuar, nga ajo del se të dënuarit secili veç e veç tek i dëmtuari krijuan bindje se do të ndikonin në vendimmarrje, kurse kjo bindje u përforcua me faktin se të dënuarit ishin persona zyrtarë, ndonëse për kryerjen e kësaj vepre penale nuk kërkohet një cilësi e tillë, por veshja e tyre me cilësi të personave zyrtarë, megjithatë ka rritur besimin e të dënuarit se të njëjtit mund të kenë ndikim tek personat që kanë marrë vendim në çështjen penale në fjalë. Aspekti i dytë në këtë çështje penale është fakti i marrjes së të hollave dhe ata shumës prej 1500 (njëmijëpesëqind) €, nga i dënuari R.I., dhe shumës prej 1000 (njëmijë) €, nga i dënuari tjetër Blerim Gashi. Megjithëse fillimisht duhet theksuar faktin se as vet të dënuarit nuk e kontestojnë pranimin e të hollave pos faktit që kontestojnë arsyen e pranimin. Por në këtë pikë, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të dy gjykatat e instancave më të ulëta kanë paraqitur arsyetim të mjaftueshëm se paratë ishin dhënë pikërisht për të ndikuar në vendimmarrjen e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë”.*

64. Duke iu referuar pjesëve relevante të Aktgjykimit [PS. nr. 14/2022] të 11 shkurtit 2022 të Gjykatës Themelore, Gjykata vlerëson se e njëjta në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar adresoi të gjitha aspektet e rastit. Fillimisht, gjykata në fjalë arsyetoi konkluzionet, përkritazi me (i) pranueshmërinë e provave vendimtare, bazueshmërinë dhe besueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve; së dyti (ii) vlerësoi vërtetësinë e provave materiale; së treti, (iii) vlerësoi aspektet ligjore të veprës penale; së katërti (iv) shtjelloi rrethanat lehtësuese dhe renduese për sa i përket vendimit për dënimin me burgim efektiv, duke arsyetuar po ashtu vendimin mbi shqiptimin e gjobës dhe të dënimit plotësues, çështje të cilat plotësisht bien në juridiksionin e saj, si gjykatë e faktit. Për më tepër, Gjykata Themelore kishte adresuar veçmas pretendimet e mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për secilën çështje apo kundërshtim të ngritur përgjatë gjykimit të rastit në seanca shqyrtuese.
65. Në vazhdim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që pretendimet kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, t'i ngriste në Gjykatën e Apelit dhe kjo e fundit, në këndvështrimin e Gjykatës, ka adresuar dhe arsyetuar të gjitha aspektet, si për sa i përket gjendjes faktike të vërtetuar, po ashtu edhe për sa i përket pretendimeve për shkelje të ligjit penal dhe procedural. Për më tepër, Gjykata vëren se pretendimet e përsëritura të parashtruesit të kërkesës ishin adresuar edhe nga Gjykata Supreme, e cila në aktgjykimin e saj, ndër të tjera, arsyetoi se, “... mbështet në tërësi arsyetimin e dhënë nga dy instancat më të ulëta dhe me fokus të veçantë në arsyetimin e mbrojtjes së të dënuarve, duke e ndërlidhur mbrojtjen e tyre me provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor”.
66. Gjykata, në dritën e parimeve të përgjithshme të GjEDNj-së, siç janë elaboruar më lart dhe bazuar në arsyetimet e gjykatave të rregullta, vlerëson se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje të plotë me standardet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës është e qartë se vendimmarrja e tyre, gjegjësisht e gjykatës së shkallës së parë nuk ishte e bazuar vetëm në një provë të vetme, gjegjësisht vetëm në deklaratimet e një dëshmitari, por edhe në prova të tjera materiale, siç në mënyrë të detajuar janë listuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të cilat si të tilla i ka konfirmuar si të drejta dhe të ligjshme Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme.

67. Prandaj, bazuar në arsyetimin e shtjelluar si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se në rastin e tij gjykatat e rregullta kanë administruar provat e çështjes, në kundërshtim me parimet e vendosura përmes praktikës së GJEDNj-së, të cilat janë të mishëruara edhe në dispozitat përkatëse të procedurës penale. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNj-së [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
68. Për më tepër, shikuar në tërësinë e saj procedura e zhvilluar pranë instancave gjyqësore në dritën e rrethanave të rastit konkret nuk ishte e padrejtë ose arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, GjEDNj, rastin, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI128/18](#), parashtrues; *Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendimi i 27 majit 2019, paragrafi 58, [KI22/19](#), parashtrues: *Sabit Ilazi*, Aktvendimi i 7 qershorit 2019, paragrafi 42, dhe [KI98/21](#), cituar më lart, paragrafi 69).
69. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës së parë, për shkeljen e të drejtës për "gjykim të drejtë dhe të paanshëm", në lidhje me mënyrën e administrimit të provave, i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve të "pambështetura ose të paarsyetuara" dhe si të tilla, të njëjtat duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese.

## ii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me "barazinë e armëve"

### a) Parimet e përgjithshme

70. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vë në pah se, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, neni 6 i KEDNj-së detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtrësive, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj (shih GjEDNj, rastin [Kraska kundër Zvicrës](#), nr. 13942/88, Aktgjykimi i 19 prillit 1993, paragrafi 30).
71. Një detyrim i tillë për gjykatat jetësohet, ndër të tjera, përmes zbatimit të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit procedural gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kuptim, GjEDNj ka nënvizuar se parimi i barazisë së armëve është element i qenësishëm i konceptit më të gjerë të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe është ngushtësisht i lidhur me parimin e kontradiktoritetit procedural (shih, rastin e GjEDNj-së [Regner kundër Republikës Çeke](#), nr. 35289/11, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146).
72. Në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, të cilën e ka ndjekur me konsistencë edhe Gjykata Kushtetuese, është theksuar në vazhdimësi se parimi i barazisë së armëve kërkon "ekuilibër të drejtë midis palëve", ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në pozitë të pafavorshme, gjegjësisht disavantazh thelbësor kundruall palës kundërshtare (shih rastet e GjEDNj-së [Yvon kundër Francës](#), nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe [Dombo Beheer B.V. kundër Holandës](#), nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33, [Feldbrugge kundër Holandës](#), nr. 8562/79, Aktgjykim i 27 korrikut 1987, paragrafi 44, shih po ashtu rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KI52/12](#), parashtruese *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut



2013, [KI103/10](#), parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40, dhe [KI193/19](#), me parashtrues *Salih Meka*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 44).

73. Duke u mbështetur në praktikën e GjEDNj-së, parimi i barazisë së armëve është i rëndësishëm sidomos në çështjet penale dhe ky parim zbatohet në të gjitha fazat e gjykimit, duke përfshirë edhe procedurën sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, siç është “kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë”. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet vendimit të GjEDNj-së, në rastin [Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), nr. 21510/03, Aktgjykimi i 31 majit 2007. Në këtë rast, një kompani që ishte palë kundërshtare në procedurë me parashtruesin e kërkesës, sikundër edhe prokurori publik, kishin paraqitur ankesë përkatësisht “kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë” në Gjykatën Supreme, kundër një vendimi të gjykatës së shkallës më të ulët. Pala tjetër (parashtruesi i kërkesës) nuk ishte njoftuar lidhur me atë kërkesë. Sipas GjEDNj-së, ankesa dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë çoi në vendimin e Gjykatës Supreme i cili ishte tërësisht i pafavorshëm ndaj palës tjetër (parashtruesit të kërkesës). Rrjedhimisht, GjEDNj-ja konsideroi se dështimi procedural për të njoftuar palën tjetër (parashtruesin e kërkesës) e ka penguar atë nga pjesëmarrja në mënyrë efektive në procedurë para Gjykatës Supreme. GjEDNj, më tutje, theksoi se “*respektimi i të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 6.1 të Konventës, kërkon që parashtruesi të ketë mundësinë që të ketë njohuri dhe të mund të komentojë apelin e kompanisë dhe kërkesën [për mbrojtje të ligjshmërisë] të prokurorit publik*” (shih, rastin [KI193/19](#), cituar më lart, paragrafi 45).
74. GjEDNj ka theksuar në vazhdimësi se i takon asaj gjykate për të vendosur se a janë zhvilluar procedurat e kontestuara, si tërësi, në përputhje me Konventën – duke përfshirë edhe nenin 6 të saj. Në këtë sfond, sipas GjEDNj-së, neni 6.1. i Konventës i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të duhur të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar se cili do të jetë ndikimi i tyre për vendimin e gjykatës (shih, ngjashëm GjEDNj, rastin [Kraska kundër Zvicrës](#), cituar më lart, [Barberà, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr. 10590/83, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988).
75. Ndërsa parimi i kontradiktoritetit procedural nënkupton që palët në procedurë duhet të kenë dijeni dhe mundësi të komentojnë dhe kundërshtojnë pretendimet dhe provat që paraqitën gjatë shqyrtimit gjyqësor (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së, [Brandstetter v. Austria](#), nr. 13468/87, Aktgjykimi i 29 gushtit 1991; [Vermeulen kundër Belgjikës](#), nr. 19075/91, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1996).
76. Duke u referuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, Gjykata potencon se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural janë të lidhura ngushtë dhe në shumë raste GjEDNj i ka trajtuar së bashku (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së, [Roëe and Daëis kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 28901/95; Aktgjykimi i 16 shkurtit 2000, [Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 27052/95, Aktgjykimi i 16 shkurtit 2000; [Zahirović kundër Kroacisë](#), nr. 58590/11, Aktgjykimi i 25 prillit 2013, si dhe rastin [KI193/19](#), cituar më lart, paragrafi 48).
77. Më tutje, GjEDNj ka theksuar se, sidomos në rastet penale, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti procedural përbëjnë elemente të rëndësishme dhe thelbësore të një procesi të rregullt gjyqësor. Prandaj, respektimi i tyre kërkon përmbushjen me rigorozitet të një sërë detyrimesh, ndër të cilat rëndësi të posaçme përbën edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për zhvillimin e një procedure, për akuzën, ankimin apo mjetin e jashtëzakonshëm të ushtruar nga pala kundërshtare. Në lidhje me këtë, në rastin [Zahirović kundër Kroacisë](#), nr. 58590/11; Aktgjykimi i 25 prillit 2013), GjEDNj, përcaktoi



si në vijim: “Gjykata përsëritë se parimi i barazisë së armëve është një element i konceptit të gjerë të gjykimit të drejtë, i cili gjithashtu përfshinë të drejtën themelore që shqyrtimi gjyqësor në raste penale duhet të jetë kontradiktor. E drejta për një shqyrtim kontradiktor, në procedura penale, nënkupton që prokuroria dhe mbrojtja duhet të kenë mundësi që të jenë në dijeni dhe të komentojnë pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala tjetër”.

78. Qëllimi kryesor i respektimit të këtyre parimeve është zhvillimi i një ballafaqimi real dhe përmbajtësor ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes, gjë e cila ndikon drejtpërdrejtë në zbardhjen e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë objektive nga gjykatat. Kërkesa të këtilla kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar nga prokurori i cili paraqet dhe mbron akuzën e paraqitur kundër të pandehurit. GjEDNj ka theksuar disa herë se kërkesat e mësipërme duhet të respektohen jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shkallët e tjera të gjykimit (shih, ndër të tjera, GjEDNj, rastin [Alimena kundër Italisë](#), vendimi i 19 shkurtit 1991, po ashtu [KI193/19](#), cituar më lart, paragrafi 50).

*b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*

79. Gjykata rikujton se shkeljen e parimit të barazisë së armëve, parashtruesi i kërkesës e ndërlidhë me faktin se Gjykata Themelore, nuk ka mundur qasje të barabartë të palëve në procedurë, gjegjësisht nuk është respektuar parimi i proporcionalitetit në mes të prokurorit dhe të pandehurit, sepse në asnjë moment nuk është bazuar në veprimet e policisë, kundër tij si i pandehur, por në deklaratimet e dëshmitarit F. Z, i cili sipas tij ishte i lëkundur dhe jokredibil, dhe se nuk ishte vlerësuar drejtë fakti se i njëjti nuk kishte planifikuar të ushtronte ndikim në ndonjë gjyqtar lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, që kishte të bënte me vet dëshmitarin F. Z.
80. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet Aktvendimit [APS. nr. 10/2021] të 22 prillit 2021 të Gjykatës së Apelit, me të cilin është aprovuar ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe ishte kthyer çështja në rigjykim në Gjykatën Themelore. Kësaj të fundit, iu kërkua që t'i administronte përsëri të gjitha provat materiale, që t'i ftonte në dëgjim edhe dy dëshmitarë të tjerë, konkretisht dëshmitarin N. K, dhe R. K, që të jepte arsye të qarta për veprimet inkriminuese të të akuzuarve, përfshirë natyrën juridike të shkeljeve, që të vërtetonte faktet vendimtare në ndërlidhje me aspektin subjektiv të përgjegjësisë penale të të akuzuarëve, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të të gjitha provave, të nxirrte konkluzione të drejta dhe të ligjshme.
81. Tutje, Gjykata vëren se në procedurën e rivendosjes, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [PS. nr. 14/2022] të 11 shkurtit 2022, bazuar në gjetjet e Gjykatës së Apelit, në detaje adresoi të gjitha vërejtjet e kësaj të fundit, duke shtjelluar në pjesë të veçanta aspektet përkitazi me dëshmitë e dëshmitareve, me besueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve, me vërtetësinë e provave materiale, me vlerësimin ligjor të veprës penale, dhe pasi shqyrtoi të gjitha çështje faktike dhe juridike, vendosi në dobi të parashtruesit të kërkesës, duke e ulur masën e dënimit me burgim efektiv nga dy (2) vjet e gjashtë (6) muaj, në njëzetë (20) muaj, dhe masën e gjobës nga 2000 mijë euro, në 1000 mijë euro. Ky përfundim i Gjykatës Themelore u konfirmua më pas si i drejtë dhe i ligjshëm nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme. (shih, më lart arsyetimin e Gjykatës Themelore, në paragrafët 50-55).
82. Gjykata e konsideron të rëndësishme të përsëris qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së nuk është drejtësi



*substantiale*, por drejtësi *procedurale*. Në rrafshin praktik, koncepti i drejtësisë procedurale nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmimeve të paraqitura nga pala kundërshtarë; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastin e Gjykatës [KI22/19](#), me parashtrues: *Sabit Ilazi*, Aktvendimi i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 dhe rastet e cituara aty, po ashtu rastin [KI98/21](#), cituar më sipër, paragrafin 59).

83. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konsideron se në rrethanat e rastit konkret janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura, për arsye se parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesi ligjor i tij, janë dëgjuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat e rregullta, se ata kanë pasur mundësi që përgjatë gjithë procedurës t'i kundërshtonin provat fajësuese, dhe t'i paraqesin ato shfajësuese. Megjithatë duket se parashtruesi i kërkesës nuk është pajtuar me vendimin e gjykatave sa i përket pranueshmërisë së provave, veçmas të dëshmitarit F. Z. Gjykata edhe më tej thekson se është në diskrecionin e plotë të gjykatave të rregullta të vendosin se cilës provë t'i falet besimi i provës së besueshme. Andaj, fakti se pretendimet e mbrojtjes nuk janë pranuar nga gjykatat e rregullta, nuk nënkupton se parashtruesi i kërkesës është vënë me automatizëm në pozitë të pabarabartë përballë organit të akuzës.
84. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përkitazi me “barazinë e armëve” i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, sepse kërkesa në këtë pjesë është qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese.

### **iii. Përkitazi me pretendimet tjera**

85. Në vlerësimin e pretendimeve tjera, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për “gjykim të drejtë dhe të paanshëm”, pretendon edhe shkelje të neneve 22, 24, 29, 30, 53 dhe 54 të Kushtetutës, dhe të nenit 5 të KEDNj-së. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe e neneve të konventave që janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të atyre neneve, në qoftë se më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre.
86. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe KEDNj-së, si dhe të instrumenteve tjera ndërkombëtare, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; dhe së fundmi rastin [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
87. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 22, 24, 29, 30, 53 dhe 54 të Kushtetutës, dhe të nenit 5 të KEDNj-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura apo të*

*paarsyetuara*” andaj, si të tilla, në baza kushtetuese të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara.

## **PËRFUNDIME**

88. Si përmbledhje e të gjitha shtjellimeve dhe analizave të mësipërme, Gjykata konkludon se: (I) pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, përkitazi me mënyrën e administrimit të provave dhe barazinë e armëve, i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve të *“pambështetura apo të paarsyetuara”* andaj, si tilla, të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; (II) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet: 22, 24, 29, 30, 53 dhe 54 të Kushtetutës, dhe nenin 5 të KEDNj-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (b), të pretendimeve të *“të paarsyetuara”*, andaj, si të tilla, të njëjtat shpallën qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese;
89. Rrjedhimisht, kërkesat e parashtruesit të kërkesës, në tërësinë e saj, duhet deklaruar e papranueshme, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, me rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur, më 23 maj 2023, njëzëri

## **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

  
Remzije Istrefi-Peci

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



  
Gresa Caka-Nimani